



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
PRESIDENTI



Nr. 38 Prot

Tiranë, më 15.01.2021

Lënda: *Përcjellim problematikat dhe shqetësimet kryesore të psikologëve shkollorë*

Drejtuar: *Znj. Evis KUSHI  
Ministre e Arsimit Sportit dhe Rinisë*

E nderuar Znj. Ministre,

Në vijim të bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet dy institucioneve tona, dëshirojmë t'Ju falenderojmë e përgëzojmë për të gjithë mbështetjen e vazhdueshme dhe interesin e shfaqur nga Ju, për të dëgjuar shqetësimet e përcjella nga psikologët shkollorë dhe angazhimin Tuaj për t'u dhënë zgjidhje atyre sa më shpejt.

Takimi Juaj me një përfaqësi psikologësh përparr fundvitit, nën një frymë bashkëpunimi, na bënë të jemi shpresplotë se shumë shqetësimeve do t'u hapet rrugë për zgjidhje.

Nisur edhe nga takimet që edhe insitucioni ynë ka realizuar me ta, po Ju përcjellim në mënyrë të përbledhur disa nga problematikat që shqetësojnë më shumë këtë kategori psikologësh.

1. Një nga problematikat kryesore që psikologët e punësuar në institucionet arsimore hasin, është mungesa e motivimit financiar, pasi megjithëse kemi të miratuar *V.K.M-në Nr. 175 datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjera jomësimorë, në arsimin parauniversitar"* deri më tanë kemi patur rritje të pagave vetëm për punonjësit mësimorë (me 15% e fundit në fillim të këtij viti) ndërsa sërisht për punonjësit psikologë paga vijon të mos jetë e ndryshuar, duke mos patur kështu asnjë motivim financiar në këtë drejtim.

Duke vlerësuar maksimalisht punën që këta psikologë kryejnë, ngarkesën e lartë në numër nxënësish, problematikat që hasin, si dhe rritjet shumë të vogla në paga në 16 vite që ky shërbim është ngritur, e gjëjmë me vend dhe legjitime kërkesën tonë për përfshirjen edhe të këtyre punonjësve në rritjet e pagave në mënyrë të njëjtë si kategoria e mësuesve.



Bhv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr.26, Kati II, Ap.9, Tiranë,  
email: [sekretaria@urdhriipsikologut.al](mailto:sekretaria@urdhriipsikologut.al), Tel.: 0035544 51 1804

2. Gjithashtu theksojmë se në ndryshim nga profesionistët psikologë, mësuesit janë pjesë e trajnimeve të ndryshme që Ju zhvilloni, në mënyrë që të kualifikohen dhe specializohen akoma më shumë në vazhdim, në kryerjen e detyrës së tyre. Një praktikë e tillë mendojmë se është një domosdoshmëri të vihet në zbatim edhe për psikologët.
3. Një tjetër shqetësim i kësaj kategorie punonjësish janë edhe distancat shumë të largëta, të cilët duhet të përshkruajnë nga një institucion në tjetrin, sidomos për psikologët që kanë në ngarkim një numër të lartë nxënësish, kryesisht në zonat rurale. Për këtë kategori psikologësh, gjykojmë se duhet të merret në konsideratë fakti për të rimbursuar kostot e transportit, që këta psikologë janë të detyruar të paguajnë, për të kryer shërbimin e tyre çdo ditë.
4. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, është edhe mungesa e vendeve vakante në insitucionet publike për kryerjen e Praktikës Profesionale për psikologët. Në fakt këtë shqetësim, institucioni ynë e ka ngritur herë pas here tek të gjitha ministritë e linjës, ku ka institacione të varësisë, në organigramat e të cilave ka të parashikuar përfshirjen e punonjësve psikologë, kjo pasi është e pamundur të përballohet numri i lartë i aplikimeve për të filluar praktikën, nga ana e insitucioneve jo publike. Për këtë arsyе do të kërkonim vëmendjen Tuaj, për të krijuar hapësirën e nevojshme, për miratimin e disa kuotave për zhvillimin e Praktikës Profesionale edhe në insitucionet publike.

Nisur nga sa më sipër kërkojmë nga ana Juaj, që të vlerësoni mundësinë e realizimit të këtyre kërkesave, për kategorinë e profesionistëve psikologë, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre pranë institucioneve arsimore, në mënyrë që jo vetëm të lehtësojmë ata nga kostot financiare e vështirësitë me të cilat përballen, në përditshmérinë e punës së tyre, por edhe që t'i stimulojmë akoma më shumë, në angazhimin e përditshëm të tyre, në kryerjen e detyrës me profesionalizëm e me përkushtimin maksimal. Ne besojmë se plotësimi i këtyre kërkesave do të ndikojë drejtëpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimit që kjo kategori punonjësish profesionistë ofron.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

**Dr. Valbona TRESKA  
PRESIDENTE**

